



REPUBLIKA E KOSOVËS
Drejtoria e Inspektionit
Glogoc, me 06.09.2019



RAPORT PËR MUAJIN GUSHT 2019

Gjatë muajit Gusht, janë bërë inspektime sipas lëmive përkatëse duke filluar nga shqyrtimi i kërkesave të qytetarve në të gjithë sektoret, pastaj është vazhduar me inspektime në teren sipas detyrave dhe agjendës ditore për secilin sektor të përcaktuar nga kërkesat e qytetarëve dhe menaxhmenti i D.I.

Duhet theksuar se të gjithë inspektorët deri në gjysmën e parë të muajit Gusht, kanë kujdestaruar gjatë organizimit të festivalit “Muaji i Mërgatës” për mërgatën shqiptare në diasporë.

Në vazhdim po ju sjellë punët e kryera nga secili sektor sipas lëmive të tyre përkatëse:

Sektori Sanitar

Në këtë muaj është vazhduar me inspektimin e subjekteve afariste hoteliere dhe salloneve të ondulimit rreth kushteve higjienike dhe sanitare, në ato subjekte që kemi hasur në parregullsi është urdhëruar për përmirësim të tyre, gjithashtu janë ri - inspektuar ato subjekte që ka kaluar afati për përmirësim të parregullsive duke marrë të gjitha masat e nevojshme sipas Ligjit në fuqi. Gjithashtu janë inspektuar subjektet ushqimore rreth afatizimit të produkteve ushqimore para festës së Bajramit.

Sektori i Tregut

Inspektim i bizneseve sipas regjistrimit të DZHE, pagesës së taksës komunale, mbarvajtja e tregut, shitësve të druve, thëngjillit e produkteve tjera tek rrethi në afërsi të rrugës “Jasharajve, janë inspektuar bizneset të cilat kanë ekspozuar artikujt jashtë lokali, është bërë shqyrtimi i kërkesave për dhënjën e pëlqimit për ushtrimin e veprimtarisë, lokalet që ushtrojnë veprimtarinë e që nuk janë të pajisura me pëlqime për ushtrim të veprimtarisë të pajisen me to, brenda afatit që i është dhënë me procesverbal.

Sektori i Komunikacionit

Janë bërë inspektime të transporuesve legal dhe atyre ilegal , por vlen të theksohet se gjatë këtij muaji kemi patur mungesë të theksuar të asistimit nga policia , sipas tyre për shkak të numrit të vogël të zyrtarve të policisë dhe aksidenteve në komunikacion, por në momentet kur ka patur asistim të policisë ju kemi bashkangjitur pikave të kontrollit sipas planit operacional.

Sektori i Ndërtimit

Është bërë verifikimi i respektimit të vendosjes së shenjës zyrtare në objektet në të cilat janë ndërprerë punimet me shenjë zyrtare.

Janë inspektuar ndërtimet në Drenas, në veçanti ndërtimet pa leje në zonat e urbanizuara në afërsi të rrugëve regjionale dhe lokale, në zonën e tokës bujqësore nën masën e komosacionit, pastaj është inspektuar shtrirja e rrjetit të KEDS-it rreth vendosjes së shtyllave dhe kabllave elektrike.

Gjatë zhvillimit të procedurave janë hartuar procesverbale të inspektimit, njoftime dhe përgjigje ndaj kërkesave.

Është bërë zbatimi i aktvendimit për rrënimin e objektit në Komoran në pronën komunale.

Sektori i Mjedisit

Nga mjedisi, është bërë shqyrtimi i kërkesave të palëve për ndotje nga mbeturinat, djegije të mbeturinave.

Inspektim i bizneseve që merren me grumbullimin e automjeteve të braktisura, për verifikimin e paisjeve me pëlqime mjedisore nga MMPH.

Është bërë inspektim i pronave private të cilat mbushen me dhe për nivelzimin e tyre, si dhe inspektim rutinor në mjedis për marrjen e masave për ndonjë parregullsi eventuale.

Në vazhdim është paraqitur pasqyra e punës në shifra për muajin Gusht , 2019

Sektori	Procesverbale	Aktvendime	Gjoha mandatore	Fletëparaqitje	Kërkesa për Pëlqim sanitar	Pëlqime Sanitare	Njoftime	Raporte	Kërkesa	Kallxime penale	Shqyrtim i kerk.	Mbyllje të lokalev	Konfiskim i targave dhe automjeteve	Konfiskim i mallit pa afat
Sanitari	22	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Treg	12	0	0	0	0	0	0	0	4	0	1	0	0	0
Komunikacion	9	0	0	0	0	0	0	0	1	1	1	0	0	0
Ndërtim	14	3	0	1	0	0	1	1	7	1	7	0	0	0
Mjedis	16	0	1	0	0	0	0	0	6	0	6	0	0	0
Totali	73	3	1	1	0	0	0	1	18	2	15	0	0	0

Shtator ,2019

UD Shef në D.I